



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për :	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 20/07/2023 Nr. 020-586
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. <del>04</del> -16-/01-0045395/23 për miratimin e kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme
I miratuar më datë: 29.06.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.07.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2023, ka miratuar Vendim nr. 02-16-/01-0045395/23 për miratimin e kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Podujevës është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-92 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Podujevës me datë 29.06.2023, me 25 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim nr. 02-16-/01-0045395/23 për miratimin e kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme bëhet me qëllim të ndërtimit të rezervuarit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



# Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za:	Shpejtim Bulliqi, gradonačelnik opštine Podujeva Hilmi Hoxha, predsedavajući Skupštine opštine Podujeva	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 20.07.2023. Br.586
Odgovorni službenici:		
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene	Driton Xhafa, viši službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Zahtev za razmatranje akta opštine Podujeva	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Podujeva	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br. 02-16-/01-0045395/23 o odobrenju zahteva Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastruktureo davanju na korišćenje nepokretne imovine

Usvojena dana, 29.06.2023.

Podnošena na razmatranje u MALS-u dana, 10.07.2023.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi. Dok, što se tiče sadržaja akta i obaveza prema drugim stranama u nadležnosti su opštine.

## Obrazloženje

Skupština opštine Podujeva, na sednici održanoj 29.06.2023, usvojila je Odluka br. 02-16-/01-0045395/23 o odobrenju zahteva Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastruktureo davanju na korišćenje nepokretne imovine.

MALS konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Podujeva zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, član 12, zakon br. 06/L-92 o davanju na korišćenje i razmenu imovine, član 21.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Podujeva dana, 29.06.2023. godine, sa 25 glasova "za", 0 "protiv" i 0 "uzdržanih". Odluka br. 02-16-/01-0045395/23 o odobrenju zahteva Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastruktureo davanju na korišćenje nepokretne imovine se radi u cilju izgradnje rezervoara.

Ministartstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 21 paragrafi 1.1, në pajtim me nenet 5 dhe 6 paragrafi 1.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në Kërkesë të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. MMPHI 3384/23 të datës 29.06.2023, Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, mori këtë;

### V E N D I M PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË MINISTRISË SË MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS, PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME

KUVENDI I KOMUNËS - PODUJEVO		
MIRATIM I VENDIMIT NR. 01-020/01-0050862/18		
Data: 10.07.2023		
Në emër të: [Signature]		
[Signature]		
[Signature]		

#### Neni 1

Miratohet Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-MMPHI, për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme me numër 01058-0 në sipërfaqe 12.145 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Shajkoc, Komuna e Podujevës.

#### Neni 2

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, ka për qëllim ndërtimin e rezervuarit sipas projektit "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në ishatin Orilan "Podujevo", konform Memorandumit të Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Podujevës me nr.6644/19-MMPH datë 11.11.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes Komunës së Podujevës dhe Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal KRU "Prishtina" me nr.1010 datë 22.05.2018 si dhe lejes së ndërtimit nr.prot.07.362/07-0022619 lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit më 01.04.2019.

#### Neni 3

Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme sipas nenit 1 sipas këtij vendimi është afatgjatë në periudhë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

#### Neni 4

Shfrytëzimi i pronës sipas këtij vendimi jepet pa kompensim.

#### Neni 5

Kontrata për dhënie në shfrytëzim e pronës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i MMPHI, pas plotësimit të të gjitha kushteve dhe kriterëve ligjore në fuqi.

### Neni 6

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme për raste të veçanta evidentohet në Regjistrin e të drejtave pronësore në Elaboratin Kadastral.


### Neni 7


Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht fushveprimtarisë së tyre.

### Neni 8

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0245395/23  
Podujevë, datë: 03 korrik 2023





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Stalnoe Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.

Date:21.06.2023

I nderuari Kryetar z. Shpejtim Bulliqi ,

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Podujevës me Nr. 6644/19, datë 11.11.2019, për bashkë financimin e projektit : "Ndërtimi i sistemit te ujësjellësit ne fshatin Orllan -Podujevë " dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Hartimin e Projektit të Sistemit të Furnizimit me ujë për fshatin Orllan -Podujevë ndërmjet Komunes së Podujevës dhe Kompanisë së ujësjellësit Rajonal "KRU -Prishtina " me Nr.1010 të datës: 22.05.2018 dhe Lejen e Ndërtimit për sistemin e ujësjellësit në fshatin Orllan -Podujevë, nga Drejtoria per planifikim urban dhe mbrojtje te mjedisit,Nr. 07.362/07-0022619/19, Podujevë 01.04.2019.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te komunës, kërkojmë :

Inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të parcelës me sipërfaqe 12.145 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Shajkoc, Numri i Parcelës 01058-0 për rezervuarin në Projektin: "Ndërtimi i sistemit te ujësjellësit ne fshatin Orllan -Podujevë", të cilin projekt është duke zhvilluar MMPHI në bashkëfinancim me Komunën e Podujevës.


Faqe 2 nga 3

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Komunës
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së



Izedin BYTYÇI

Page 3 nga 3